

# IProjekti i Sigurisë së Transmetimit Rajonal të Beverly

## Vështrim i përgjithshëm

Projekti i Sigurisë së Transmetimit Rajonal të Beverly është një projekt i rëndësishëm rajonal i infrastrukturës së transmetimit elektrik nga National Grid. Qëllimi i projektit është të zëvendësojë një kablo ekzistuese të transmetimit elektrik nëntokësor të vendosur në pjesë të Salem dhe Beverly, Massachusetts. Fillimisht të instaluar në vitin 1971, këto kablo të vjetruara janë drejt fundit të procesit të tyre dhe tani duhet të zëvendësohen. Duke filluar në nënstacionin e ri të Waite Street në Salem, duke u lidhur me nënstacionin ekzistues të National Grid të River Street në Beverly dhe duke përfunduar në nënstacionin ekzistues të National Grid East Beverly, kabulli i ri do të furnizojë me energji rrjetin lokal, duke u shërbyer rreth 50,000 klientëve që përdorin energjinë elektrike në Beverly, Essex, Gloucester, Hamilton, Manchester, Rockport dhe Wenham.

Vitet e fundit, National Grid ka bërë riparime të shumta të kablove për të mundësuar furnizimin e vazhdueshëm të besueshëm të energjisë elektrike për klientët e zonës tonë. Nëpërmjet Projektit të Sigurisë së Transmetimit Rajonal të Beverly, ne kemi planifikuar të zëvendësojmë kabullin aktual me një sistem të ri kabllor modern. Zëvendësimi i kabullit do të përmirësojë sigurinë elektrike në zonën e Beverly-Cape Ann, do të minimizojë kostot e mirëmbajtjes dhe riparimit dhe do të sigurojë kapacitet për zhvillimin e zonës në të ardhmen.

## Procesi i ndërtimit

Kur të fillojë ndërtimi, në rrugë mund të shihni kontraktorë të cilët presin sipërfaqen e asfaltuar të rrugës. Kjo pasohet nga gjurmimi i kanalit. Gjatë gjurmimit, ekipet e gjurmimit do të gërmojnë një kanal të gjerë rreth tridhjetë centimetër dhe do të sjellin materiale të përshtatshme në kanal përpara se të instalojnë tubin nëntokësor. Pasi të jetë vendosur tubi, mbi të do të hidhet beton për të krijuar një kanal për kablo nëntokësor. Pasi kanali për kablo nëntokësor të jetë vendosur, ekipet do të mbushin pjesën e gjurmuar dhe do ta mbulojnë kanalin me një pjesë asfalti të përkohshme. Pas përfundimit të projektit, rrugët që janë pjesë e projektit do të shtrohen nga trotuari në trotuar.

Faza e parë e ndërtimit pritet të fillojë në fund të vitit 2021 në pronën e National Grid në cep të rrugës Waite dhe Ferry Street, ndërsa ekipet do të punojnë për të ndërtuar një nënstacion të ri në kantier. Nëse kushtet atmosferike janë të përshtatshme, ndërtimi në rrugë pritet të fillojë në tremujorin e parë të 2022.

## Angazhimi ynë

Ne do të ndërtojmë infrastrukturën e re në mënyrë të sigurt dhe të besueshme duke shkëmbyer gjerësisht informacion, në mënyrë që të vazhdojmë t'i shërbejmë komunitetit tonë edhe në të ardhmen. Gjatë gjithë projektit, do të përqijemi maksimalisht për të përditësuar klientët tanë komercialë dhe rezidencialë dhe banorët e tjerë në lidhje me punimet e ardhshme, ndikimet dhe mbylljet e mundshme të rrugëve dhe të mbajmë një dialog të hapur dhe proaktiv rreth projektit me fqinjët dhe partnerët tanë në Beverly dhe Salem.

Për të qëndruar të përditësuar për secilën fazë të projektit nga fillimi deri në fund, ju lutemi mos harroni të vizitoni faqen tonë të internetit në [www.BeverlyRegionalTransmissionReliabilityProject.com](http://www.BeverlyRegionalTransmissionReliabilityProject.com) dhe regjistrohuni për përditësime të tjera me email. Ju gjithashtu mund t'i dërgoni email ekipit tonë të projektit në [info@BeverlyRegionalTransmissionReliabilityProject.com](mailto:info@BeverlyRegionalTransmissionReliabilityProject.com) ose të na kontaktoni përmes numrit të telefonit të kontaktit të ekipit tonë 1-833-238-4743.

## Rreth National Grid

Në National Grid, jemi të përkushtuar të ofrojmë energji të sigurt dhe të besueshme për më shumë se 20 milionë klientë në të gjithë New York, Massachusetts dhe Rhode Island.

Biznesi kryesor i National Grid është furnizimi me energji elektrike dhe gaz natyror. Ne jemi gati të ofrojmë energji në mënyrë efikase, të besueshme dhe të sigurt për klientët dhe komunitetet tona, dhe për të mbrojtur mjedisin tonë për brezat e ardhshme. Ky projekt i propozuar është pjesë e një plani të gjerë nga National Grid për të forcuar sistemin tonë të transmetimit elektrik për t'u shërbyer më me besueshmëri klientëve tanë, tani dhe në të ardhmen.

*\*Për shkak të kompleksitetit të ndërtimit të jashtëm, orari mund të ndryshojë*

